



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PER MBIKQYRJE TE FINANCAVE
PUBLIKE

DHJETOR 2016

DËGJIM PUBLIK I DATES 21.12.2016 TE ORGANIZUAR NGA KOMISIONI
PER MBIKQYRJE TE FINANCIVE PUBLIKE

Projektligji për kontrollin e brendshëm financiar

Kryesues i dëgjimit publik, Faton Topalli, kryetar i Komisionit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Përfaqësues të Njesisë Qendrore Harmonizuese,
Përfaqësues të Asociacionit të Komunave dhe Auditorit të Përgjithshëm,
Përfaqësues të Mediave,
Ju faleminderit që keni ardhur në këtë dëgjim publik. Të ftuar janë edhe organizata të ndryshme nga Shoqëria civile,
Përhëndes edhe këshilltarin e ministrit,
Si po duket, deri më tash, nuk ka ndonjë interes të madh, dhe megjithatë, të gjithë ata që janë të interesuar kanë mundësi t'i japin propozimet e tyre.

Ne sot po shqyrtojmë njërin nga ligjet shumë të rëndësishëm se i përket mbikëqyrjes dhe kontrollit të financave publike, Ligj i cili mund të na rregullojë shumë çështje të hapura sa i përket financave publike.

Në fakt, sot më shumë jemi këtu në cilësinë e deputetëve si palë që dëgjon dhe që ka mundësi t'i dëgjojnë propozimet që i japin palët tjera për ndryshimin e Ligjit.

Prandaj, pa humbur kohë, do të kalojmë menjëherë në temë, dhe ia kisha dhënë fjalën së pari përfaqësuesit të Njesisë Qendrore Harmonizuese të na thotë shkurtimisht për çfarë bën fjalë Ligji dhe lidhur me të ta bëjë një prezantim të shkurtër.

Po them të shkurtër, sepse ne e kemi lexuar Ligjin dhe, të flasë ndoshta më konkretisht për vërejtjet eventuale që ekzistojnë qysh tani.

KOSUM ALIU: Faleminderit kryesues!

Fillimisht dëshiroj të përhëndes të gjithë të pranishmit dhe ju si kryesues, anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Shoqërinë civile dhe mediat e pranishme.

Ne, edhe në takimin e parë, kur kemi bërë leximin e parë të Projektligjit, në njëfarë mënyre, kemi bërë shpjegimin se çka përmban ky ligj.

Unë do të mundohem që, në pika të shkurtra, të jap një shpjegim, kryesisht për ata të cilët ndoshta nuk e kanë dëgjuar më herët dhe të dinë pak se si është i strukturuar Ligji dhe cili është qëllimi i këtij ligji.

Çështje kryesore, e trajtuar në këtë projektligj, është rirregullimi i Kornizës ligjore të kontrollit të brendshëm të financave publike nëpërmjet fuqizimit të këtij kontrolli në subjektet e sektorit publik në Republikën e Kosovës.

Qeveria e Kosovës, në prill të vitit 2015 e ka miratuar Strategjinë e kontrollit të brendshëm të financave publike 2015-2019. Strategjia i përcakton objektivat dhe veprimet për zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, i përbërë nga menaxhmenti financiar, kontrolli dhe auditimi i brendshëm.

Korniza ekzistuese ligjore për kontrollin e brendshëm të financave publike, ndonëse përmban parimet e përgjithshme dhe i referohet standardeve të pranura ndërkombëtarisht, duhet ende të adaptohet sipas ndryshimit e zhvillimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe auditimit të brendshëm brenda standardeve ndërkombëtare.

Në kontekst të legjislacionit të BE-së, fusha e rregullimit të këtij projektligji lidhet me Kapitullin 32 të AKI-së për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Ky kapitull përbëhet nga 3 pjesë kryesore: Kontrolli i brendshëm i financave publike; Auditimi i jashtëm, dhe Mbrojtja e interesave financiare të BE-së.

Projektligji i kontrollit të brendshëm të financave publike përbëhet prej 6 kapitujve dhe ka gjithsej 36 nene.

Në kapitullin 1 të Projektligjit janë rregulluar qëllimi, fushëveprimi dhe përkufizimet e përdorura në Projektligj.

Kapitulli 2 i Projektligjit rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin, ku rregullohet llogaridhënia menaxheriale e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik, zyrtarit kryesor administrativ, zyrtarit kryesor financiar, drejtuesve të niveleve vartëse dhe të mbajtësve tjerë të buxhetit në subjektet e sektorit publik.

Po ashtu, ky kapitull rregullon komponentet e menaxhimit financiar, të kontrollit dhe raportimit për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike.

Auditimi i brendshëm rregullohet në kapitullin 3 të Projektligjit, ku rregullohen themelimi, funksionimi, parimet e auditimit të brendshëm si dhe komitetet e auditimit të brendshëm.

Ky kapitull po ashtu e rregullon pavarësinë funksionale të njësive të auditimit të brendshëm, përbërjen dhe rekrutimin e stafit, përgjegjësinë e udhëheqësit të subjekteve të sektorit publik për këtë njësi si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me funksionin e kësaj njësie.

Në kapitullin 4 trajtohen bashkërendimi dhe harmonizimi i kontrollit të brendshëm të financave publike, ku rregullohen përgjegjësitë e Ministrisë së Financave, Këshillit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike dhe të Njesisë Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar, Kontroll dhe Auditim të Brendshëm.

Në kapitullin 5 përcaktohen hapat për raportimin e parregullsive.

Kapitulli i fundit trajton dispozitat përfundimtare dhe kalimtare në tranzicion.

Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave publike është në përputhshmëri të plotë, me obligimet që burojnë nga MSA.

Ky projektligj avanco më tej bashkëpunimin e palëve të MSA si dhe bashkëpunimin e Njesisë Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin e Brendshëm dhe Auditim të Përgjithshëm.

Ministria e Financave i ka analizuar detajet e implikimit financiar të këtij projektligji.

Projektligji nuk do të kërkojë kosto shtesë për zbatimin e tij në krahasim me dispozitat aktuale ligjore.

Burimet e nevojshme për zbatimin e Projektligjit sigurohen nga burimet e planifikuara të subjekteve të sektorit publik kryesisht për pozitat e pagave, mëditjeve dhe trajnimeve.

Gjithashtu, zbatimi i Projektligjit që për synim ka mënyrën, sigurimin më të arsyeshëm të themelit, funksionimit të auditimit të brendshëm dhe strukturën e

menaxhimit financiar e kontrollit, mund të shpijë në zvogëlimin e shpenzimeve aktuale apo, nëse ka nevojë, në rishpërndarjen e shpenzimeve, për pasojat e një qasjeje të tillë do të jenë në total nën ndikim financiar neutral në burimet buxhetore lidhur me kostot e zbatimit të Projektligjit.

Po ashtu Projektligji nuk do të krijojë struktura të reja organizative që kërkojnë kosto të reja financiare.

Duke pasur parasysh çështjet e parashikuara në këtë projektligj, ju ftoj për debat dhe të gjitha çështjet të cilat ju i konsideroni se duhet të trajtohen në veçanti, ne jemi në gjendje t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Këtu kemi përfaqësuesin e Auditorit të Përgjithshëm, të Asociacionit të Komunave dhe ju kisha lutur, nëse keni propozime apo vërejtje – ato t'i bëni!

RAMADAN GASHI: Faleminderit! Jam Ramadan Gashi, prej Zyrës kombëtare të Auditimit.

Nuk kemi ndonjë çështje shumë substanciale në këtë ligj, por përjashtimisht, dy çështje që ia vlejné të theksohen, janë te neni 29: – Zyra Kombëtare e Auditimit.

Është një përfaqësues nga Zyra Kombëtare e Auditimit, merr pjesë në punimet...

Dhe, aty duhet të theksohet “Zyra Kombëtare e Auditimit”, jo edhe “e Auditorit të Përgjithshëm”.

Është kjo çështje teknike, mirëpo sido që të jetë, kërkohet të bëhet ky përmirësim, sepse është e normuar si përfaqësuese nga Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm.

Terminologjia e përdorur në Ligjin tonë për Zyrën e Auditimit thuhet “Zyra Kombëtare e Auditimit” dhe jo “Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm”. Është këtu një ngatërrim i termave.

Po ashtu, edhe në nenin 31, kemi po të njëjtin emërtim dhe kërkojmë që të përmirësohet kjo, e të jetë: “Zyra Kombëtare e Auditimit”.

Çështje tjera substanciale, nuk kemi vërejtur. Këto ishin që duhej theksuar.

KRYETARI: Është folur shumë për rrogat e auditorëve... A nuk është kjo temë që duhet përfshirë?

Dakord, faleminderit!

Lidhur me çështjen e asociacionit të komunave, sepse ka të bëjë shumë edhe me komunat kjo çështje dhe nëse ka mundësi, apo keni vërejtje konkrete tani, por edhe më vonë, sigurisht se do të keni mundësi t'i paraqitni.

SAZAN IBRAHIMI. Faleminderit kryetar Topalli!

Të nderuar deputetë, është kënaqësi që në emër të asociacionit, si mekanizëm i cili avokon e lobon në emër të komunave, që t'i paraqes disa nga pikëpamjet e komunave në këtë projektligj.

Ne kemi diskutuar në Asociacionin e Komunave të Kosovës përkatësisht në mekanizmin e quajtur Kolegjium i drejtorëve komunalë për buxhet e financa, e po ashtu e kemi diskutuar këtë projektligj edhe gjatë hartimit me Ministrinë e Financave sepse kemi një bashkëpunim shumë të sinqertë dhe të mirë, jo vetëm në hartimin e këtij projektligji por edhe akteve tjera ligjore e nënligjore.

Pra, mund të konstatojmë se me këtë ligj avancohet procesi sa i përket kontrollit dhe llogaridhënies nga autoritetet lokale, sepse pikëpamjet tona do të shfaqen edhe nga autoritetet lokale apo nga komunat e Kosovës.

Nëse i referohemi raporteve të Auditorit të Jashtëm të deritanishme, në disa vite të fundit, në shumicën e komunave të Kosovës si e gjetur ka qenë mungesa e kontrolleve të brendshme, dhe një e gjetur gjithmonë që i ka përcjell komunat ka qenë mungesa e kontrolleve të brendshme, andaj si ligj u ka munguar institucioneve për nivelin lokal dhe ne mirëpresim një ligj të tillë.

Më herët kanë qenë të ndarë secili nga akterët, të cilit i është dhënë një kompetencë sa i përket kontrollit të brendshëm financiar, që kanë qenë të rregulluara me ligje specifike apo ligje sektoriale dhe është mirë që me këtë ligj, të gjithë akterët kryesorë, sa i përket menaxhimit të brendshëm financiar e kontrollit dhe llogaridhënies, të jenë në një ligj.

Unë pajtohem me këtë ligj dhe me parafolësit që janë të definuara qartë kompetencat e aktorëve kryesorë sa i përket zyrtarit kryesor administrativ, zyrtarit kryesor financiar dhe auditorit të brendshëm.

Andaj, në emër të komunave të Kosovës e përkrahim si Projektligj dhe është i mirëseardhur për autoritetet lokale.

Tash do të flas vetëm për disa nene, sa i përket asaj se kemi parë që ka pak konfuzion për disa çështje.

Do të thotë në faqen 3, neni 3, paragrafi 1.15.7, te udhëheqësi i subjektit të sektorit publik, këtu është edhe kryetari i komunës.

Pra, në paragrafin 1.15.7 është edhe kryetari i komunës për subjektet e qeverisjes lokale dhe tash nëse ne i referohemi nenit 5 në këtë ligj, ka konfuzion sepse këtu shkruan në një paragraf se “kryetari i komunës, si zyrtar kryesor administrativ, i raporton, në atë kuptim, vetvetes”. Pra, është te neni 5, paragrafi 1.

Më tutje thuhet: “dhe i raporton udhëheqësit të sektorit publik” Do të thotë, zyrtari kryesor administrativ, sipas nenit 3, në nivelin lokal, është kryetar i komunës.

Dhe këtu, në nenin 5, thotë se “zyrtari kryesor administrativ, e në këtë rast, është kryetari i komunës, i raporton udhëheqësit të sektorit publik, që është, do të thotë Kryetarit të Komunës.

Kjo me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, është shumë qartë e përcaktuar se kryetari i komunës i raporton në baza tremujore.

(Ndërhyrje)

Shumë mirë po më vjen, se shumica keni shkuar nëpër kuvende komunale, që është pozitive.

Do të thotë, në baza tremujore e ka për obligim t’i raportojë kuvendit komunal dhe gjithashtu ai raporton shkon edhe në Ministrinë e Financave.

Këtu mendoj se duhet të jetë ashtu qysh është paraparë me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale që kryetari i komunës apo në këtë rast zyrtari kryesor administrativ duhet t’i raportojë kuvendit komunal, siç është paraparë me Ligjin sektorial mbi pushtetin lokal.

(Ndërhyrje)

Po, kuvendit komunal. Dhe, nëse më lejohet do të vazhdoja...!

KRYETARI: Po, vazhdoni, vazhdoni!

SAZAN IBRAHIMI: Te neni 4, paragrafi 1.6 është si vijon: “për caktimin e strukturës adekuate organizative, ndarjen e detyrave”, është shumë mirë e përshkruar në këtë paragraf dhe ne si asociacion kërkojmë që këto obligime, që dalin nga ky paragraf i këtij neni, të përcillen edhe me akte nënligjore, edhe pse në këtë projektligj është paraparë që aktet nënligjore do të nxirren brenda 6 muajve, por në bazë të përvojës tonë si asociacion i komunave të Kosovës, këto nuk janë përcjell, zakonisht, brenda 6 muajve por kalojnë edhe vite.

Prandaj, ne besojmë se Ministria e Financave do të marrë parasysh këtë, që është shumë me rëndësi për autoritetet lokale, dhe ky ligj do të përcillet edhe me akte nënligjore.

Te neni 7... Është pak problem, sepse ne si Asociacion i komunave të Kosovës kemi qenë të involvuar edhe në hartimin e katalogut të vendeve të punës, i cili është nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike.

Tash ne kemi një dilemë, jo vetëm me këtë projektligj por edhe me projektligjet tjera, kemi pasur dileme të natyrës së njëjtë, sepse ky projektligj parasheh zyrtarin kryesor financiar, kurse katalogu i vendeve të punës nuk e parasheh këtë pozitë.

Tash, a duhet referuar komunave katalogun e vendeve të punës, apo këtij ligji?

Ne kemi pasur edhe Ligjin për barazitë gjinore, që me atë ligj komunat janë të obliguara të kenë zyrtarin për çështje gjinore, pastaj zyrtarin për efikasitet të energjisë, e tjera, e tjera, mirëpo katalogu i vendeve të punës nuk i parasheh këto vende të punës, apo këto pozita, dhe është mirë që Ministria e Financave është konsultuar me Ministrinë e Administratës por kur po vjen koha e implementimit po kanë problem komunat, sepse po marrin dy vendime të cilat po jenë në kundërshtim me njëra-tjetrën nga ministrinë e ndryshme të linjës dhe për këtë arsye unë mendoj që duhet të elaborohet edhe një herë në detaje dhe t’i jepet komunave një sqarim kur implementohen këto se kush duhet të ketë prioritet, a katalogu apo ky ligj.

Edhe te nenet 33 dhe 34 pak kanë konfuzion. Është këtu interesant se thotë “neni 33 paragrafi 3, thotë “përfshihet nga paragrafi 1.1. i nenit 4, pagat e auditorëve të brendshme rregullohen me Ligjin Numër 03/L-128 për auditimin e brendshëm,”

kurse neni 34 thotë “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen edhe Ligji për auditimin e brendshëm”.

(Ndërhyrje)

Tash, do të thotë, unë po i paraqes si shqetësime e ju pastaj e keni për obligim t'i paraqitni.

Pra, këto disa çështje të cilat u ngritën nga komunat gjatë diskutimit të cilin e kemi pasur për Projektligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha një lutje, nëse është e mundshme, se vërejtjet që i patët të na i dërgoni me shkrim, pra me propozime e ide, të cilat i keni. Një kopje na e dërgoni ne si Komision, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore Harmonizuse, të dakordoheni.

Tash fjalën ia kisha dhënë përfaqësuesve të organizatave joqeveritare apo të interesuarve tjerë, të cilët kanë ndoshta vërejtje sa i përket ligjit, apo kanë propozime konkrete. Urdhëroni, dhe të gjithë ata që e marrin fjalën, le të prezantohen.

VAHIDE GRAJÇEVCI: Faleminderit i nderuar kryetar!

Unë jam Vahide Grajçevci, auditore e brendshme e Kuvendit të Kosovës.

E mora fjalë me arsyen që t'i diskutoj disa çështje që prekin auditimin e brendshëm në Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Çështja e parë, që e ceku edhe kryetari, në të cilën është diskutuar shumë çështja e pagave të auditorëve të brendshëm. Ne dimë në çështjen e pagave ka qenë edhe pozita e auditorëve dhe drejtorëve të njësive të auditimit të brendshëm e rregulluar më herët me Ligjin për auditimin e brendshëm 128 dhe me Ligjin për auditimin e brendshëm 074.

Po ashtu, me këto ligje kanë qenë të rregulluara edhe funksionimi e përbërja e njësive të auditimit të brendshëm sipas nivelit buxhetor të organizatave buxhetore.

Nga vetë ky fakt dhe nga organizimi i njësive të auditimit të brendshëm, në bazë të këtyre ligjeve që njëri është i shfuqizuar dhe tjetri është në shfuqizim e sipër, në bazë të këtij projektligji që po diskutohet tani, vërehet se edhe kërkesat të cilat kanë qenë të përfshira në atë ligj, nuk kanë qenë të vëra në funksion apo nuk kanë qenë të zbatuara atëherë, prandaj jam e detyruar të them që me këtë ligj të

rregullohet çështja e pagave të auditorëve të brendshëm, të mos mbetet siç e tha kolegu një nen në fuqi i ligjit i cili do të shfuqizohet, por të rregullohet kjo çështje në një nen të këtij ligji.

Pra, të precizohet saktë çështja e pagave me një nen, e të mos mbetet të rregullohet me ndonjë rregullore tjetër. Sepse me Rregulloren e funksionimit të njësive të auditimit të brendshëm, siç thashë edhe më herët, ka qenë i rregulluar funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm sipas nivelit buxhetor, por ka raste kur kjo kërkesë nuk është e rregulluar, edhe pse është kërkuar me rregulla dytësore.

Nëse edhe kjo çështje tash e pagave lihet të rregullohet me një rregullore tjetër, atëherë frikohem se s'do të rregullohet si duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka të interesuar tjetër që të japin propozime, vërejtje? Urdhëroni, mund ta merrni fjalën, edhe një herë!

SAZAN IBRAHIMI : Kryetar, vetëm sa i përket çështjes së pagave. Duhet t'ju informoj dhe disa nga deputetët e dinë se në disa komuna paga e auditorit të brendshëm është më e lartë se e kryetarit të komunave. Pra, për këtë arsye, ne si Asociacion i Komunave të Kosovës kemi qenë të involvuar në hartimin e Projektligjit për paga dhe besojmë se të gjitha këto çështje dhe të gjitha këto brenga duhet zgjidhur përmes Ligjit për paga, dhe besojmë se Parlamenti i Republikës së Kosovës do ta miratojë këtë ligj sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka të interesuar tjerë, përveç deputetëve, të marrin fjalën? Urdhëroni!

(Ndërprerje e shkurtër)

MENTOR HYSENI: Jam Mentor Hyseni dhe vi nga GIZ-i!

Ne kemi analizuar Ligjin për kontroll të brendshëm dhe auditim të brendshëm dhe kemi disa komente, disa teknike e disa thelbësore, por po i ceku ato thelbësoret që janë.

Çështja e pagave u diskutua shumë gjatë. Ne i kemi analizuar dhe konsiderojmë se do të ishte mirë të marrim një analogji me Auditorin e Përgjithshëm, kryesisht stafi i auditorëve të brendshme që paguhet atje, dhe të rregullohen përmes këtij ligji ose një udhëzimi të brendshëm administrativ, por që duhet të merret një analogji me Auditorin e Përgjithshëm.

Arsyeja pse, është se kryesisht fusha e veprimit është e njëjtë, metodologjia e punës është e njëjtë, pavarësia që kërkohet ndoshta duhet të jetë në nivel më të lartë se është pak e rrezikuar nga se është në institucion apo brendapërbrenda institucionit dhe kjo çështje duhet të rregullohet.

Çështja e komiteteve të auditimit është çështje se në Kosovë është lënë pak anash dhe kryesisht edhe kur krijohen ato komitete të auditimit janë kryesisht stafi i brendshëm i atij institucioni, që ne kemi konsideruar se një staf i pavarur prej jashtë profesionist si për shembull prej pjesës akademike universitare, mund të është edhe ndonjë kandidat i pavarur, dhe nëse komiteti përbëhet prej 3 anëtarëve, 2 nga këta 3 anëtarë duhet të jenë staf i pavarur e jo staf brendapërbrenda Ministrisë.

Do të thotë janë dy çështje thelbësore që sigurojnë pavarësinë e auditimit të brendshëm, çështja e pagave dhe çështja e raportimit. Këtyre dy elementeve duhet kushtuar rëndësi, përndryshe nuk do të kemi një funksion të mirëfilltë të Auditimit të Brendshëm.

Kjo çështje është bërë me ligjin paraprak, kur është rregulluar, bile atëherë edhe unë kam qenë anëtar i Komisionit për draftimin e ligjit dhe është shti në nen, brendapërbrenda ligjit që është garantuar paga e auditorit, mirëpo qëllimi i saj ka qenë që të ngritët pavarësia e auditorit, ngase gjithmonë po flasim se auditori i brendshëm nuk respektohet, nuk ka pavarësi funksionale, ka presion prej stafit të brendshëm, prandaj ne ta rregullojmë përmes këtij ligji dhe është mundësia e fundit të sigurohet një pavarësi e auditorit të brendshëm.

Pjesën teknike të përmirësimeve i dërgoj me shkrim kur Komisioni punues angazhohet dhe i diskutojmë prapë bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Mentor! A ka të interesuar tjerë? Po, udhëroni!

LABINOT LEKAJ: Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë jam Labinot Lekaj, nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit - auditor i brendshëm. Një herë kam qenë edhe anëtar i Grupit punues për draftimin e ligjit.

Unë të them, në vazhden e diskutimeve të Mentorit dhe të koleges nga Kuvendi i Kosovës do ta diskutoja më shumë çështjen e pagave, pasi që ky ligj shumë qartë e përcakton pavarësinë funksionale të auditorëve të brendshëm, mirëpo nëse nuk

rregullohet çështja e pagave përmes këtij ligji, dhe po flas në emër edhe të një grupi më të madh të auditorëve – kolegëve të mi të auditimit të brendshëm të institucioneve, atëherë pavarësia funksionale do të mbetet vetëm në letër.

Ne jemi dëshmitarë të faktit se ballafaqohemi me punë në terren dhe e dimë se si trajton menaxhmenti auditimin e brendshëm, ose kur e kemi rastin e katalogut të vendeve të punës, ku është rast eklatant dhe auditori i brendshëm krahasohet me një zyrtar për barazi gjinore.

Është pra shumë absurde nëse krahasohet puna kështu e auditorit të brendshëm. Respekt për zyrtarët e barazisë gjinore dhe respekt për të gjithë zyrtarët tjerë, por puna, kompetenca, përgjegjësitë e auditorëve të brendshëm janë të mëdha.

Ne jemi kategori në ligj për deklarimin e pasurisë dhe çdo auditor i brendshëm, në të gjitha institucionet i deklaroi pasurinë për shkak të kompetencës, për shkak të përgjegjësisë dhe për shkak të ndjeshmërisë së punës së tij.

Njësia e auditimit të brendshëm është njësi që përgatit planet ndaras, strategjinë dhe planin e punës i përgatit me aktivitete të veçanta prej organizatës buxhetore. Do të thotë përgjegjësia me ligj është jashtëzakonisht e madhe, andaj pagat, mendoj se do të duhej të përcaktohen përmes ligjit.

Ne mund të marrim analogji edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit apo të një praktike të mirë të dikujt, por është mirë të ceken në ligj, për shkak se vetëm me ligj sepse qeveritë, që sot është një qeveri, nesër vjen tjetra, ndërrohen, por ne si praktikë të punës e kemi ne vetëm me dëshmi. Dhe, nëse na sigurohet përmes ligjit, atëherë është në rregull, përndryshe është çështje shumë e ndjeshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! U përmend çështja e pagave nga disa diskutues këtu, por nuk pati ndonjë propozim konkret, me përjashtim të propozimit të GIZ-it dhe unë kisha lutur që ata që kanë propozime konkrete le t'i bëjnë si propozime konkrete.

(Ndërrhyrje)

Po mirë, mendoj se ka mendime të ndryshme edhe sa i përket kësaj. Dakord! Faleminderit! A ka ndokush tjetër që ka ndonjë vërejtje? Unë do ta bëja një pyetje për ju. Ndoshta jam ekspert i kësaj çështjeje, por ligji ka një dhe definon përgjegjësitë, por nuk kam parë se ka ndonjë pjesë të ligjit ku dikush nuk e kryen

detyrën e tij. Cilat janë masat, cilat janë ndëshkimet, cilat janë përgjegjësitë që i kërkon ligji për atë që s'i ka kryer detyrat?

_____: Realisht, është një kapitull që flet për masat në ligj, është i përgjithësuar, mirëpo prej këtij neni derivojnë ligjet tjera të cilat i zgjedhin këto çështje. Do të thotë përgjegjësia apo llogaridhënia është në krejt nivelin e ligjit, por qëllimi i hartimit të këtij ligji është ngritja e llogaridhënies menaxheriale, që i kanë dy drejtime. Delegimi i detyrave të bëhet prej larg – poshtë, ndërsa llogaridhënia të bëhet prej poshtë – lartë.

Do të thotë është shumë mirë e funksionalizuar kjo pjesë. Mirëpo neni 32, që flet për procedurat për raportimin e parregullsive. Do të thotë është një nen i cili përcakton se çka duhet bërë auditori i brendshëm ose secili zyrtar kur hasë në parregullsi. Do të thotë, është i obliguar t'i lajmëroi organet kompetente dhe pas marrjes nga auditori i brendshëm shkon deri te kryesuesi i vet, deri tek ministri ose kryetari i komunës dhe kryeshefi ekzekutiv. Pastaj, ajo përgjegjësi është e tyre për ta çuar problemin më tutje.

Por, në raste të veçanta, nëse menaxheri nuk reagon është i obliguar ta çojë te organet kompetente si në prokurori apo në organe kompetente për luftimin e parregullsive. Domethënë, është e rregulluar në njëfarë mënyre me ligj. Mirëpo, nuk kemi paraparë masa, sepse po e kuptoj, ti sipas të gjitha gjasave po mendon të caktohen masat e dënimit sa duhet të jenë, masa administrative apo masa tjera që nuk janë të parapara me ligj, sepse mendojmë që nuk është kompetencë...

KRYETARI: Problemi është se gjatë punës, kemi parë se implementimi i rekomandimeve nuk bëhet, përkundër bazës ligjore, përkundër asaj që duhet kërkuar përgjegjësi, nuk implementohen dhe kurrkush s'jep përgjegjësi. Prandaj, edhe e shtrova këtë pyetje.

Por, ne shpresoj do ta diskutojmë në komision....

(Ndërhyrje)

Po, e di, por kjo ishte pyetje sqaruese.

_____: Implementimin e rekomandimeve duhet sqaruar. Implementimi i rekomandimeve është një përgjegjësi ekskluzive e menaxhmentit të organizatave buxhetore duke filluar prej kryesuesit dhe subjekteve të caktuara publike.

Nëse e keni parë nenin e përgjegjësive të kryesuesit të sektorit publik, me këtë ligj rritet niveli i përgjegjësisë të parit të organizatës, duke i shtrirë delegimet teposhtë secili do të japë llogarinë. Pra, kjo do të thotë se është krijuar shumë mirë një zinxhir i llogaridhënies.

Tani me këtë ligj bëhet përgjegjës ministri, kryetari i komunës, kryeshefi ekzekutiv për krejt funksionimin e organizatës buxhetore.

Nëse më lejohet, unë do të kisha vazhduar pak. E mbajta një shënim por nëse kam kaluar diçka, më ndihmoni edhe ju. Pra, dua të jap një shpjegim sipas këtyre problemeve që u ngritën këtu.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ne do të kemi edhe takime tjera, do t'i diskutojmë këto, në mënyrë konkrete.

_____: Po por kjo çështja e pagave, është çështje pak më....

(Ndërhyrje dhe ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Mirë! Ka kërkesa që të dëgjohet diçka sa i përket çështjes së pagave. Urdhëroni, lidhur me pagat, çfarë mendimi keni.

_____: Çështja e pagave! Temë e cila ka filluar kohëve të fundit të diskutohet shumë, prej momentit kur ka filluar të përgatitet katalogu i pagave... Në ligjin e parë që është bërë në vitin 2006 për auditimin e brendshëm, paga e auditorit të brendshëm ka qenë e cekur me një nen ato dhe ka thënë paga e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë e barabartë me pagën e sekretarit permanent.

Pastaj, në ligjin e dytë...

(Ndërhyrje)

Po de! Është pastaj ligji tjetër, i cili thotë se paga e auditorëve të brendshëm duhet të jetë e përafërt me pagën e drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm.

Tash (DASHC-ja) ka nxjerrë një vendim konform kësaj, i cili ka përcaktuar koficientët, ku thotë – drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm duhet ta ketë

pagën 20, derisa auditori i brendshëm duhet ta ketë pagën 15. Kjo në shumicën e organizatave buxhetore, për të mos thënë 95% është zbatuar, por ka disa organizata buxhetore tek-tuk që nuk është zbatuar, dhe deri më tani kjo merret kështu. Do të thotë kjo është paga të cilën e merr auditori.

Në momentin kur ka hyrë në fuqi katalogu, është publik, domethënë është në ueb-faqen e Ministrisë së Administratës Publike dhe shihet që paga e auditorit të brendshëm është vendosur në koeficientin 8, paga e drejtorit të divizioneve, që diku i kanë quajtur divizione e diku i kanë quajtur departamente – është 6 dhe paga e Departamentit të Auditimit të Brendshëm është koeficienti 4.

Do të ndalem në atë gamën pak më të madhe të auditorët, që i bie se nëse paga e auditorit do të merret me këtë katalog, të përgjysmohet. Dhe ky është një shqetësim i auditorit të brendshëm dhe ka kërkesa të shumta që kjo çështje të rregullohet me ligj, përkundër asaj që, siç thotë Sezami, kjo çështje të rregullohet me Ligjin e pagave që në bazë të kësaj strukture aktuale, është e pamundur. Realisht, nuk dimë qysh kemi me e vendosur këtë pagën aktuale, qysh do ta mbrojmë këtë pagë.

E tash, logjika e uljes së pagës nënkupton atë që e tha Mentori në njëfarë mënyre, por ndoshta edhe është momenti i fundit që ne të bëjmë një zgjidhje këtu dhe të referohemi në bazë të përgjegjësisve dhe kërkesave për trajnim e certifikim shtesë... Tash auditori i brendshëm nuk e ka vetëm një punë, ai do të auditojë prej zyrës së ministrit e deri te të gjitha zyrat. Do të thotë duhet të jetë i përgatitur në tërë legjislacionin, nuk ka punë vetëm me një ligj. Dhe ai duhet të japë opinione, duhet të japë këshilla e rekomandime për menaxhmentit se si të përmirësohet funksionimi i sistemit. Realisht, është një përgjegjësi pak më e madhe.

Por, kur të kesh parasysh anën tjetër, që e tha kolegu, edhe pse për auditorin e brendshëm ne e kemi gojën plot pavarësi, por është pak, s'di qysh të them... Auditori i brendshëm nuk mund asnjëherë të jetë i pavarur, bile edhe në asnjë vend të botës, mirëpo ne po synojmë që të ngrisim atëfarë pavarësie. Do të thotë t'i mbajmë ata auditorë të brendshëm.

Unë besoj dhe jam shumë i sigurt se nëse bie deri te nivelizimi i pagave kësisoj, auditorët e brendshëm do të gjejnë hapësirë tjetër.

Unë do të jap një shembull që në 2008, kur unë kam ardhur drejtor në këtë njësi, 19 auditorë të brendshëm vetëm se morën një certifikatë të SOF-REKOS, ikën, na i morën organizatat tjera, bankat, na i mori KEK-u dhe që Mentori pati shkuar në

KEK. Pra, 19 brenda një muaji ditësh na patën ikur për shkak të pagës, sepse me një pagë të njëjtë nuk rri në kualitet.

Për informimin tuaj, ne që 6 muaj ditë jemi duke marrë me certifikimin e Auditorit të Brendshëm, është një shkollë shtesë për ta, është një profesion shtesë për ta, është një kualifikim shtesë për ta dhe ne presim që me 28 t'i certifikojmë edhe 58 auditorë të ri, që shfrytëzoj rastin publikisht të ju ftoj të gjithëve në atë ceremoni që do të mbahet në sallën e Qeverisë P-38.

Do të thotë është një përgjegjësi që ndoshta, po them, meriton pagesë më të mirë. Sikur që tha Sezami, paga e drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm është më e madhe se e kryetarit. Më e madhe nuk është, por dallon diku, përreth 100 euro. Realisht është ajo që po dua të them...

(Ndërhyrje)

Jo për auditorin, por kryetari i merr 69 euro më shumë, saktësisht.

KRYETARI: Do të thotë kjo çështje e rrogave është një problem, të cilin ne duhet ta diskutojmë dhe të bëjmë propozime konkrete.

_____: Po unë e kam edhe një çështje të cilën desha ta them.

KRYETARI: A është propozim konkret, për ndryshim? Nëse ka mundësi, le ta dëgjojmë.

_____: Është konkret një propozim. E përmendi përfaqësuesi i Zyrës Kombëtare të Auditimit nenin 29 dhe nenin 31.

Ne, kur e kemi bërë draftligjin, e kemi bënë bashkëpunim me ekspertë të Komisionit Evropian, mirëpo edhe një herë kemi kërkuar të marrim një konfirmim prej Bashkimit Evropian se ky ligj është në harmoni të plotë me standardet.

Komisioni Evropian e ka autorizuar SIGMA-n të merret me atë punë dhe ai më ka ardhur së fundi, pra një rekomandim prej tyre, pikërisht për këtë nen, i cili thotë:

“Në nenin 39 përcaktohen pjesëmarrësit, kush do të jetë pjesë Këshillit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, dhe ata kanë kërkuar një fleksibilitet që t'i lihet qeverisë dhe qeveria do t'i përcaktojë njerëzit aty kush duhet të jetë.

Prandaj, në njëfarë mënyre unë mendoj se duhet të pajtohemi me këtë kërkesë të tyre, sepse Qeveria është ajo e cila do njerëz të përgjegjshëm që do ta monitorojnë ... këtë pjesë. Dhe me u fshi vetëm ajo pjesa që ne themi se duhet të jetë ky, ky, ky dhe të vendosë Qeveria të cilët njerëz do t'i vendosë aty.

Edhe nja dy çështje tjera teknike, që janë lëshime më tepër të shkruara, por ato do t'i bëjmë me shkrim.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, e keni fjalën!

ALI SADRIU: Në një mënyrë e tha Kosumi dhe unë do të rezervohem, meqë sot janë në funksion më tepër të marrim këshilla prej tyre.

E kam pasur dhe e kam atë brengë se si t'i sigurojmë pavarësi Auditorit të Brendshëm. Flas nga përvoja. Kanë pasur dhe kanë ata probleme, sepse ende menaxhmentet tona, në të gjitha nivelet thuaja se e kuptojnë si rival, si oponent, dhe realisht ajo është dora e djathtë e vetë menaxhmentit dhe ka pasur shumë raste që i kanë larguar, i kanë ndëshkuar, e tjera, dhe ne duhet të përkushtohemi të sigurojmë mekanizma mbrojtës.

Mekanizmi mbrojtës do të jetë, nuk është vetëm paga, edhe pse është paga një element shumë i rëndësishëm, janë edhe kontratat e punës, diku i kanë me kontratë, i mbajnë 1 vit, 2 vite, 3 vite dhe nëse s'i pëlqen e ndërron, e bie tjetrin, e bie një të dëgjueshëm.

Ne do të përkushtohemi që ato kontrata të jenë pak më ndryshme. Llogaridhënia e Auditorit të Brendshëm i dedikohet jo menaxhmentit, por duhet t'i dedikohet Këshillit apo Komitetit të Auditimit. Pjesë e Komitetit të Auditimit duhet të jetë kryetari i komunës ose edhe vetë ministri, le të jetë një organ më i gjerë ku dëgjohen të gjitha sugjerimet se Auditori i Brendshëm duhet të jetë më tepër prevenues. Ai duhet të jetë në koherencë të marrjes së vendimeve dhe menaxhmenti të japë sinjale se nëse e merr këtë vendim e ka këtë, këtë e këtë, ose e ka këtë e këtë përparësi, prandaj ai duhet të jetë më i afërt, jo në cilësinë e një auditori ose inspektori klasik që e kemi menduar ne të kaluarën.

Prandaj, nuk e kemi lehtë, por gjithsesi kjo rreth pagës e ka komplikuar, por bashkërisht unë propozoj që edhe ky të vjen në grupin punues atje ku i finalizojmë dhe do të përkujdesemi të gjejmë mekanizma ligjorë mbrojtës që ai ta kryen punën e vet në mënyrë profesionale dhe publike, normalisht.

KRYETARI: Faleminderit! Mund të them që, ne si deputetë mund të ndalemi pak për të biseduar shkurtimisht për punën e një punëtorie që mund ta mbajmë, por meqë s'ka propozime tjera, unë ju falënderoj përzemërsisht për angazhimin dhe edhe një herë po ju them që vërejtjet mund t'i dërgoni me shkrim dhe të gjithë të interesuarit tjerë mund t'i dërgojnë.

Ne si Komision mund të them jemi angazhuar shpejt ta procedojmë ligjin dhe dëshirojmë që ta kryejmë shpejt, sepse konsiderojmë që është i rëndësishëm. Faleminderit edhe një herë!